

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik të projektdokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë Durrës për periudhën 2026-2028.

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë.

Qëllimi: Konsultim publik me banorët dhe grupet e synuara të interesit dhe ato të marginalizuara të Bashkisë Durrës ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me ndryshimet apo propozimet për ndryshime të projektdokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë Durrës për periudhën 2026-2028.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet **online në faqen web të bashkisë Durrës për periudhën 15 Korrik – 15 Gusht 2025.**

Sugjerimet janë të mirëpritura **deri më datë 16 Gusht 2025**, në adresën e emailit:

keshillidurres@gmail.com

Pjesëmarrës:

- Këshilli Bashkiak dhe Administrata e Bashkisë Durrës.
- **Nga komuniteti:** Banorët e Bashkisë Durrës, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, gjimnazet, mësuesit, përfaqësues të komuniteteve fetare në Durrës, grupe të ndryshme interesi apo grupet e marginalizuara, etj.

Forma e konsultimit: Online.

Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik synon përfshirjen e mendimeve, sugjerimeve dhe rekomandimeve të komunitetit lidhur me projektdokumentin e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë Durrës për periudhën 2026-2028. Ky proces është një mundësi e rëndësishme për qytetarët dhe grupet e interesit për të shprehur pikëpamjet e tyre dhe për të kontribuar në hartimin e buxhetit të ardhshëm të Bashkisë. Nëpërmjet këtij konsultimi, do të sigurohet që drafti i buxhetit të jetë sa më afër nevojave të komunitetit dhe qytetarëve, duke reflektuar prioritetet e tyre për zhvillimin ekonomik, social dhe infrastrukturor për këtë periudhë.
Përshkrimi i çështjes.	Miratimi i draftit të projekt buxhetit është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton fondet që do të përdoren për të gjitha shërbimet / funksionet e ushtruara nga Bashkia dhe performancën e tyre. Këshilli i Bashkisë sigurohet që fondet publike shkojnë për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga Bashkia për komunitetin dhe adresojnë nevojat e tyre, brenda kapaciteteve financuese të Bashkisë. Për këtë, Këshilli i Bashkisë do të organizoj këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve për të qenë sa më afër komunitetit dhe nevojave të tyre.

Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit të sekretariatit të Këshillit Bashkiak, BRENDA DATËS 16 Gusht 2025. keshillidurres@gmail.com
Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme	Opsionet e mundëshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit : Alokimin e fondeve për programe të caktuara me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia dhe investimet të projektdokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë Durrës për periudhën 2026-2028.
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, në lidhje me cështjen që konsultohet.	Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t'i gjeni në faqen Web të bashkisë, faja kryesore. https://durres.gov.al/category/bashkia/njoftime/ https://durres.gov.al/konsultimet-publike/
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon: 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave të çdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë; 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. 5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 6. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 7. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; 8. Monitorimi i zbatimit të tij.
Data e publikimit	15.07.2025